



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:020482

Datë: 16.09.2018

Numri i dokumentit: 00122233

P.nr.8/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilijana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit A. Q. nga V, për shkak të veprës penale mbajtja ne pronësi ,kontroll ose posedim te paautorizuar te armëve nga neni 374/1të KPRK-ës ,sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore - DP në Gjakovë, PP .nr. 243/17 dt. 05.01.2018., në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **16.09.2018**, në prani të Prokurorit te shtetit Xhavit Osmani dhe te akuzuarit A. Q., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **A. Q.**, nga fsh. V. K Pejë ,Rr ”.... “, i biri i R. dhe i nënës L. e gjinisë Sh., data e lindjes në A. R. F. Gjermane, ka te kryer shkollën mesme, i pa punë, i gjendjes se varfër ekonomike, ashkali, shtetas i R. Kosovës, i pa martuar, me nr. ID

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

-pasi qe me pare ka siguruar e gjere me dt. 19.02.2017,rreth orës 17.05min. ne Gjakovë ,ne rrugën “N.T.” ,pa autorizim ka mbajtur arme e municion e ne kundërshtim nenin 4 par 1 nen par 1.1te Ligjit për Armët të Republikës te Kosovës,te cilat sipas ligjit kategorizohen si armë zjarri te ndaluar dhe atë : një (1) elektroskok te markës “G. P. “ tipi,ngjyrë e zezë , ashtu qe para gjykatës armen –elektroskok e kishte ekspozuar ne shitje e i është gjetur nga zyrtari policor dhe i është sekuestruar ,e qe gjendet ne shkresat e lendes..

-me çka ka kryer vepër penale mbajtja ne pronësi ,kontroll ose posedim te paautorizuar te armeve nga neni 374 par. 1 te KPRK-së.

Andaj Gjykata me aplikimin e neneve 6.17, 41, 49,50,51,62, 73,75,76, nenit 374 par.1, te KPRK-se nenit 248 dhe 365 te KPPK-se, të akuzuarit i shqipton :

DENIM ME KUSHT

Duke ja shqiptuar dënimin me burgim ne kohe zgjatje **prej 1(një) viti**, i cili dënim nuk do te ekzekutohet po qe se i akuzuari brenda kohës se verifikimit në afatin prej **2 (dy) viteve** ,nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari që ti paguaj shpenzimet procedurale shumen e përcaktuar nga gjykata si dhe në emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej **30,00 €** , në afat prej **15 ditëve** ,pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcenim të përmbartimit me dhunë .

Gjykata ne kuptim te dispozitës 62 par.2 pika 7 lidhur me nenin 69 par.1 dhe nenit 374/3 të KPRK-ës, të akuzuarit ,ia shqipton masën :

MARRJA E SENDEVE

Një (1) elektrohok te markës “G. P. “ tipingjyrë e zezë , si objekt i veprës penale e cila është sekuestruar nga ana e zyrtarëve policor me dt.19.02.2017, e cila ndodhet ne shkresat e lendes .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.243/17 të dt.05.01..2018, e ka akuzuar të akuzuarin A. Q. nga Gjakovë për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedimi te paautorizuar të armëve nga 374/1 të KPRK-së.

Gjykata konstaton se ndaj te akuzuarit A. Q. me dt. 03.08.2018 ka lëshuar urdhëresë për shpallje te leterreshtimit me qene se i njëjti nuk ka marr pjesë ne seancat e caktuara nga ana e gjykatës ndërsa nga st. policor ne Gjakovë duke vepruar sipas urdhëresës se kësaj gjykate te dt. 12.07.2018 ,jemi njoftuar me nr ref. 04/1-08-GJ-S-2018/18 te dt.02.08.2018, se i njëjti është kërkuar ne adresën e dhënë por i njëjti ndodhet ne Gjermani dhe kur vinë ne pushime jetojnë ne Pejë e këtë informatë e kanë marr nga te afërmit e tyre A. dhe A. Q. me nr. tel

I akuzuari me dt. 15.09.2018 është ndaluar nga st.policor duke vepruar sipas kësaj urdhëresë ndërsa me dt. 16.09.2018 është sjellë ne lokalet e gjykatës i cili u procedua dhe ndaj te njëjtit është bere tërhiqja e urdhëresës për shpallje te leterreshtimit .

Prokurori i shtetit Xhavit Osmani ,gjatë shqyrtimit fillestar me dt.16.09.2018, lexoi aktakuzën PP.nr.243/17 të dt.05.01.2018 dhe deklaroi se mbeti ne tërësi pranë kësaj aktakuzës.

I akuzuari A. Q. ,gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryera me arsyetim se të njëjtën nuk e kam keqpërdorë asnjëherë dhe qëllimi im ka qene qe ta shes për te fituar diçka me qene se jetojmë ne një gjendje shume te varfër ekonomike , ku asnjeri nga anëtarët e familjes nuk punojmë e po ashtu nuk e kam ditur se mbajtja e një elektrohoku është vepër penales apo konsiderohet si arme e palejuar . I propozoi gjykatës që duke marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë në këtë fazë të procedurës, pendimin e shprehur për veprën e kryer si dhe faktin se është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin, të më shqiptojë një dënim më të butë.

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë prokurori e shtetit Xhavit Osmani , deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favoret juridike të pranimin të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, nga të cilat vërtetohet gjendja faktike si në aktakuzë.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari A. Q. : - pasi që me pare ka siguruar e gjere me dt. 19.02.2017, rreth orës 17.05min. në Gjakovë ,në rrugën “N.T” ,pa autorizim ka mbajtur arme e municion e në kundërshtim nënin 4 par 1 nën par 1.1te Ligjit për Armët të Republikës të Kosovës, të cilat sipas ligjit kategorizohen si armë zjarri të ndaluar dhe atë : një (1) elektroskok të markës “G. P “ tipingjyrë e zezë , ashtu që para gjykatës armen –elektroskok e kishte ekspozuar në shitje e i është gjetur nga zyrtari policor dhe i është sekuestruar ,e që gjendet në shkresat e lëndës..

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë ,për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat ,gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nënin 248 të KPPK-ës. Gjate pranimin të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë ,pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit ,gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga nëni 73 të KPRK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimin. Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, mosha e tij relativisht e re në kohën e kryerjes së veprës penale, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari , pendimin e tij , sjelljen korrekte në gjykim , premtimin se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, gjendjen e varfer ekonomike si dhe faktin se i njëjti me parë nuk ka qene i dënuar nga ana e gjykatës . Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata të akuzuarit A. Q. , i shqiptojë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari gjatë kohës së verifikimit në afat prej 2(dy) viteve , nuk do të kryej ndonjë veprë tjetër penale, me bindjen e plote se ky dënim është në harmoni me peshën e veprës penale ,shkallen e përgjegjësisë se të akuzuarit dhe se gjykata është e bindur se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit do të arrihet qëllimi i dënimin nga nëni 41 të KPRK-ës .

Vendimi për konfiskimin e Një (1) elektroskok të markës “G. P. “ tipingjyrë e zezë , është marrë bazuar në nënin 62 par.1 pika 2.7 lidhur me nënin 374par.3 të KPRK-ës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale në të përcaktuara nga gjykata dhe në emër të paushallit gjyqësor në shumë prej 30,00 € ,është bazuar në dispozitat e nënit 450 par.1 dhe 2 nën paragrafi 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.8/18 më datë 16.09.2018.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij në dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.